

FJALA E DEPUTETES ANDIA ULLIRI

E ENJTE 27 JANAR 2022

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Sot në këtë seancë parlamentare na është paraqitur një projektligj, i cili ka të bëjë me një marrëveshje midis Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Zhvillim për rehabilitimin me eficiencë energjetike të konvikteve studentore të universiteteve publike në Shqipëri. Duke qenë se jam edhe deputetja më e re e kësaj legjislature, mendoj se më takon të them disa fjalë për studentët shqiptarë. Gjatë diskutimeve të zhvilluara për këtë projektligj vura re se është vërtet për t'u mahnitur fakti se si kjo qeveri mund të tentojë ta manipulojë edhe fjalën transparencë thjesht për të mos dhënë llogari për zhvillimin e fazave të mëparshme të kësaj marrëveshje. E them këtë, sepse i gjithë procesi i investimeve në këto konvikte është shoqëruar nga mungesa e transparencës financiare dhe gënjeshtria, si ajo e kryebashkiakut të Tiranës, i cili premtoi se studentët do të akomodoreshin në godinat e reja në tetor të vitit 2021, por, siç u vu re, kjo nuk ndodhi. Lind pyetja: çfarë ka ndodhur me 3 fazat e para të kësaj marrëveshje? Cilat kanë qenë ndërhyrjet në godinat ekzistuese dhe në godinat e reja? Çfarë performance në eficiencë energjetike kanë pasur këto ndërhyrje dhe a e kanë arritur qëllimin? Mjafton të bisedosh me studentët dhe të vizitosh godinat e tyre dhe do të shohësh më se qartë se kushtet mbeten ende dëshpëruese, ndërsa kostot e akomodimit janë shtrenjtuar.

Studentët shprehen se kushtet në këto godina nuk kanë pasur ndryshimin e pritur ose të afishuar nga qeveria. Qeveria, e ndodhur nën presionin e protestave të studentëve, 3 vjet më parë doli me një dokument të quajtur Pakti për Universitetin, të cilin gjatë kësaj seance e kanë shitur si një arritje shumë të madhe. Në këtë dokument flitet për konviktet, tarifatat dhe infrastrukturën. Në këtë pakt u premtua se do të merrreshin masa për ndërtimin e godinave akomoduuese në disa qytete, ku njëri prej tyre ishte dhe Durrës, duke cilësuar se ishte një nga kërkesat primare të studenteve të atij qyteti. Ende sot vazhdon që kjo çështje të jetë e pazgjidhur dhe prezente në kërkesat e studentëve të universitetit të Durrësit. Mungesa e konvikteve është kosto shtesë për studentët, duke qenë se opsionet e tyre janë të limituara. Ata përballen sot me tarifa të larta shkollore, me mungesë të hapësirave publike, me pamundësinë e garantimit të një transporti publik dinjitoz. Mbase në muajt në vijim do të dëgjojmë më shumë për këto çështje, duke qenë se qeveria, si pjesë e premtimeve fasadë elektorale, do të përpiqet t'i bindë studentët e Durrësit se do të ketë ndryshime gjatë këtyre viteve, duke marrë parasysh se ata kanë 8 vjet qeverisje dhe asgjë nuk ka ndryshuar.

Studentët shqiptarë me plot fjalë sot janë të neglizhuar pa arsye. Është më e lehtë ta dëbosh popullin tënd sesa t'i garantosh një jetesë të mirëfilltë në vendin e tij. Pra, jetojnë në një shtet ku çmimet e materialeve bazë vetëm rriten, ndërkohë që cilësia e tyre pëson ulje. Të rinjtë sot përballen me papunësinë, varfërinë dhe reformat e dështuara të arsimit Fenomeni i largimit të të rinjve nga Shqipëria është më i larti se kudo tjetër në Europë dhe këtë fakt e mbështet edhe INSTAT-i, duke thënë se në vitin 2021 janë regjistruar 12,5 % të rinj më pak në universitet, krahasuar me vitin 2017. Dita ditës të rinjtë po largohen nga Shqipëria për një jetesë më të mirë, madje edhe ilegalisht.

Studentët dhe të rinjtë për qeverinë janë thjesht disa rreshta shtesë në premtimet e tyre elektorale. Duan të tregojnë se kanë shkëlqyer në arsim, por sot fëmijët detyrohen të ndërpresin mësimin prej disa ditësh vetëm sepse qeveria e saj nuk i ka marrë masat e duhura për të përballuar të ftohtin. Këto janë më shumë fakte që pasqyrojnë neglizhencën e tyre ndaj familjeve shqiptare. Është momenti që ne të diskutojmë këtu për çështje, të cilat na shqetësojnë ne si popull dhe të adresojmë problematikat e këtyre të rinjve; problematika që shpesh nuk gjejnë zë, të cilat fshihen me paradat më të shëmtuara propagandistike të kësaj qeverie, duke nisur me titujt e blerë të kryebashkiakut të Tiranës “Tirana kryeqyteti i rinisë”. Çdo i ri, që e dëgjon këtë titull, është i detyruar të mos e mendojë dy herë largimin sa më parë nga ky vend, ku gënjeshtër është kryefjala e retorikës së atyre, të cilët vijnë me pretendimin se janë legjitimë. Si anëtare e Komisionit të Edukimit dhe Medies, e dënoj cenimin e fjalës së lirë, që tashmë është kthyer në një epidemi kombëtare. Ishte kjo qeveri, e cila doli me pretendimin se do të bënin çmos t’i siguronin qytetarët nga sulmet kibernetike, por, me sa duket, ato fonde shkojnë jo për popullin, por për të parandaluar të dalë e vërteta në shesh, duke sulmuar portalet e medieve herë pas here për të ruajtur karriget e pushtetarëve dhe këto fakte vijnë nga ngjarjet e fundit. Për t’u rikthyer aty ku nisëm, duhet të kuptojmë se një marrëveshje e tillë ka kaluar 3 faza dhe sot ata kërkojnë të miratojnë fazën e 4- të, duke thënë se çdo gjë bëhet për t’u ardhur në ndihmë studentëve.

Për një qeveri, e cila shquhet për korrupsion, mungesë në transparencë dhe eksperte në censurë, është vështirë të besohet se arsimi e rinia janë primare ndokund. Nëse nuk do të marrim masa për të hartuar politika, të cilat u vijnë në ndihmë brezave të rinj, gjykoj se nuk do të mbeten të rinj për t’u ndihmuar. Faleminderit!